




KOMUNA JUNIK

RAPORTI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS

2023





DE RMBAJTJA

02

Fjala e Kryetarit

03.

Vendimet, Subvensionet

04.

Menaxhimi i burimeve
njerëzore

05-06

Drejtoria për Administratë
të përgjithshme

07

Drejtoria për Buxhet dhe
Financa

08

Sektori i Tatimit në Pronë

09

Dëgjimet Buxhetore

10-11

Drejtoria për Ekonomi, dhe
zhvillim

12-13

Drejtoria për Urbanizëm
Kadastër dhe Mjedis

14-15

Drejtoria për Arsim,
Kulturë, Rini dhe Sport

16

Drejtoria për Shëndetësi
dhe Mirëqenie Sociale

17

Qendra Për Punë Sociale e
Junikut

18-19

Drejtoria për Shërbime
Publike Inspeksion
Mbrojtje dhe Shpëtim

20

Riasfaltimi i rrugës Gaxherr
- Shalaj - Bajraktar

21

Asfaltimi i segmentit
Gjocaj-Livadhi i madh në
rrugën Junik-Gjeravicë

22

Hapja e rrugës fushore
Troja në lagjen Qestaj

23

Ndërtimi i urë mbi lumin
Erenik që lidh dy eko
fshatrat Gjocaj dhe Jasiq

24

Kanalizimit në lagjet Miroc,
Gaxherr, Çok dhe Bajraktar

25

Ndërtimi i kanaleve të
ujtjes 4100 m

26

Punimet në muret
mbrojtëse dhe Kanalet e
Ujitjes në Lagjet Tofaj dhe
Pepsh

27

Punimet në përmirësimin
e infrastrukturës në
amfiteatrin e hapur në "
Moronicë" dhe në parkun
përgjatë lumit Erenik

28

Vendosja e rrethojave
mbrojtëse për sigurinë e
fëmijëve dhe qytetarëve të
Junikut

29

Vendosja e Shportave për
Mbeturina

30

Sinjalizimi i rrugëve në
komunën e Junikut

31

Objekti i ri i SHFMU
"Edmond Hoxha"

32

Gjimnazit "Kuvendi i
Junikut" me Panele solar
me sistem akumulues

33

Ndërtimi i parkut "Sheshi i
Dëshmorit të Kombit
Gëzim Pepshi"

34

Ndërtimi i parkut të
lodrave për fëmijë pranë
lumit Erenik

35

Pastrimi i Deponive Ilegale
në Komunën e Junikut për
të Ruajtur Ambientin
Natyror

36

QKMF në Junik
funksionalizohet 24/7,
gjithashtu është
funksionalizuar edhe
aparatura e rentgenit

37

Të gjithë me plisa - Plisi
Shqiptar në Unesco

38

Turneu i pingpong- ut të
seniorëve "Dita e
Pavarësisë" në Junik

40

Koncerti i organizuar nga
Komuna e Junikut për
nder të mërgimtarëve
junikas

41

Mirëmbajtja e ndriçimit
publik

42

Mirëmbajtja e hapsirave
publike

43

Mirëmbajtja e kanalizimit
të ujrave të zeza

44

Mirëmbajtja e urave mbi
shtratin e lumit Erenik

45

Mirëmbajtja e dimërore e
rrugëve lokale

46

Dekorimi i qytetit të
Junikut për festat e
fundvitit

47

Nënshkrimi i marrëveshjes
binjakëzimit me komunën
Nuthe Urstromtal-
Gjermani

48

Punimet në Zyrën
Informuese të Turizmit,
materialet promovuese,
web faqja



FJALA E KRYETARIT

Kryetari i Komunës së Junikut, dëshiron të shprehë falënderimet e tij të thella për të gjithë qytetarët junikas për besimin, bashkëpunimin dhe përkrahjen e tyre të palodhur gjatë vitit 2023.

Në vitin e kaluar, me përkushtim dhe angazhim të vazhdueshëm, kemi arritur të realizojmë një sërë projektesh dhe punë të rëndësishme për komunitetin tonë. Përmes bashkëpunimit tuaj, kemi arritur të përmirësojmë infrastrukturën komunale, shërbimet sociale, dhe kemi bërë përparime në fushën e arsimit dhe kulturës, shëndetësis.

Dëshiroj të përcjell një falenderim të veçantë për ekipin qeverisës dhe zyrtarët komunal, të cilët kanë punuar me përkushtim dhe profesionalizëm për të ndihmuar në realizimin e qëllimeve tona të përbashkëta.

Për vitin 2024, synojmë vazhdimin e punës së palodhur për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve tanë. Projekte të reja dhe inovative janë në planifikim, dhe ne kemi bindjen se, me mbështetjen tuaj të vazhdueshme, do të kemi një tjetër vit të suksesshëm dhe përparim për komunën tonë.


Faleminderit përsëri për besimin tuaj të palëkundur. Së bashku, po ndërtojmë një të ardhme më të mirë për të gjithë. Ju uroj shëndet dhe sukses në vitin e ardhshëm! Me respekt,

Z. Ruzhdi Shehu
Kryetar i Komunës së Junikut



ZYRA E KRYETARIT

Vendimet e Kryetarit




Aktet e Kryetarit të Komunës

Neni 43

Përpos Përgjegjësi të përcaktuara me nenin 41 të këtij statuti, kryetari i komunës nxjerrë urdhëresa administrative dhe vendime brenda fushëveprimit të kompetencave të tija.

VENDIMET, RREGULLORET MARRVESHJET, MEMORANDUMET, BINJAKZIMET E KRYETARIT GJATE VITIT 2023



SUBVENSIONET NGA KOMUNA PËR VITIN 2023

21

Subvensione
Shëndetësi

71

Bursa për
Studentë

2

Subvensione
OJQ

2

Subvensione
Kulturë



ZYRA E KRYETARIT

Menaxhimi i burimeve njerëzore

Në vitin 2023, Zyra e Burimeve Njerëzore ka realizuar me sukses të gjitha procedurat e nevojshme në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale. Koordinimi i ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit të Personelit (DPMZ) në Prishtinë ka rritur efikasitetin dhe ka siguruar një implementim të përsosur të politikave dhe udhëzimeve në fushën e burimeve njerëzore.

Ankesat e kandidatëve të ndryshëm janë adresuar në kohë dhe në mënyrë profesionale nga komisioni i procedurës. Kjo ka kontribuar në ruajtjen e një imazhi pozitiv të organizatës dhe ka treguar përpjekjet e vazhdueshme për të respektuar të drejtat dhe kërkesat e kandidatëve gjatë procesit të rekrutimit.



Numri i te Titulli i pozitës punësuarve	Te përfunduara	Ankesa	Përgjigje ne ankesë
2 Drejtor te shkollave	Po	Po	Po
1 Mjek i përgjithshëm	Po	Jo	Jo
1 Sekretar i shkollës	Po	Jo	Jo
2 Mësimdhënës i lendes se matematikës	Po	Jo	Jo
1 Mësimdhënës i lendes se Artit Figurativ	Po	Jo	Jo
1 Mësimdhënës e lendes se Gjuhës Angleze	Po	Jo	Jo
2 Mësimdhënës i lendes kimisë	Po	Jo	Jo
3 Asistente për fëmijët me nevoja te veçanta	Po	Jo	Jo
1 Mësimdhënës i Edukatës Fizike	Po	Jo	Jo
1 Specialist i TIK-ut në Shkolla	Po	Jo	Jo
1 Inspektor Komunal	Po	Po	Po
1 Zyrtar i larte për buxhet dhe financa	Po	Jo	Jo
1 Zyrtar për procedimin e te dhënave	Po	Jo	Jo




Drejtoria për Administratë të përgjithshme

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME ËSHTË E NDARË NË TRE SEKTORË:

- Sektori për Administratë të Përgjithshme,
- Sektori i Gjendjes Civile dhe
- Sektori Pritës, Protokoll dhe Arkivë.

Në Drejtorinë e Administratës në periudhën Janar – Shtator, në tre sektorët e saj: Sektorin për Administratë të Përgjithshme, Sektorin për Gjendje Civile dhe Sektorin Pritës, Protokoll dhe Arkivë, ka pasur mbarëvajtje të mirë të punës, punë kjo e realizuar në përputhje me Statutin e Komunës, Planin e Punës, ligjet, rregulloret, udhëzimet dhe vendimet në fuqi.

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme me mbështetjen e Kryetarit të Komunës, për herë të parë që nga themelimi i Komunës, ka organizuar zgjedhjet e Këshillave Lokale.



12272

Lëndë të pranuar në
Qendrën për shërbimin me
qytetarë

7430

Dokumente të
lëshuara nga
Gjendja Civile

6828

Lëndë të Arkivuara



DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme me mbështetjen e Kryetarit të Komunës, për herë të parë që nga themelimi i Komunës, ka organizuar zgjedhjet e Këshillave Lokale.

1

Këshilli lokal i fshatrave Gjocaj dhe Jasiq

2

Këshilli lokal i lagjeve urbane Gacafer, Qendër, Pepsh dhe Bajraktar

3

Këshilli lokal i lagjeve urbane Krasniq, Miroc, Gaxherr dhe Shala

4

Këshilli lokal i lagjeve urbane Berishë, Goqaj, Qestaj

4

Kryetar të këshillave lokale

18

Anëtar të kryesive të këshillave për çdo këshill

14 - 4

Meshkuj - Femra
ku zgjedhja është bërë sipas përcaktimit të secilit Këshill për numrin nga (5-7-9)




DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Zotimi i mjeteve për të gjitha programet e Komunës Junik sipas kërkesave të Drejtorive

1,130 Zotime

828 – Zotime në Modulën e Aprovimeve

302 – Zotime në Modulën e Blerjeve




Shpenzimet, Çertifikimin dhe aprovimin e të gjitha lëndëve për pagesa të ndryshme, deri më tani janë çertifikuar – aprovuar dhe proceduar për pagesë në Freebalanc

1,096- Lëndë të programeve dhe të kategorive të ndryshme ekonomike

285 – Shpenzime, çertifikime – aprovime me Modul të Blerjes

811 Çertifikime – aprovime me Modul të Aprovimeve






DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Sektori i Tatimit në Pronë

Zyra e Tatimit në Pronë, për shkak të ndryshimeve në Ligjin mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme, gjatë këtij fillim viti është ballafaquar me shumë pakënaqësi prej qytetarëve rreth faturimit të faturave për Objekte dhe Parcela rezidenciale për vitin 2022.

Faturimi i faturave për vitin 2023 për objekte dhe parcela bëhet nga Departamenti i Tatimit në Pronë, ku me datën: 23.01.2023 kemi pranuar njoftimin zyrtar se faturimi i faturave ka përfunduar me sukses.

- 119,481.63 € Faturimi i faturave nga tatimi për objektet-parcela për vitin 2023**
- 102,019.00 € Planifikim i të hyrave nga tatimi për objekte-parcela për vitin 2023**
- 113,499.64 € Inkasimi i të hyrave Janar-Dhjetor 2023**






DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Dëgjimet Buxhetore

Dëgjimi i parë Buxhetore i mbajtur me 15.06.2023




Dëgjimi i dytë Buxhetore i mbajtur me **Gratë** me 25.07.2023



Dëgjimi i tretë Buxhetore i mbajtur me 15.08.2023



Dëgjimi i parë Buxhetore i mbajtur me 15.09.2023





Drejtoria për Ekonomi, dhe zhvillim

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Junikut, është e ndarë në tre sektore,

Spektori për Bujqësi

Spektori për Pylltari

Spektori për Zhvillim Ekonomik dhe Biznese

Në drejtori janë të punësuar 10 zyrtarë, katër roje të pyjeve dhe dy teknik të pyjeve që menaxhohen nga agjencia e Parkut Kombëtarë " Bjeshkët e Nemuna".

PERFITUES TE GRANDEVE	PROJEKTI
7 Gra	Women for Women
19 Fermerë	HELP "Përfshirja dhe Fuqizimi Ekonomik në Ballkanin Perendimor"
05 Biznese	NaturKosova
101 Fermerë	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

99


Aktvendime
për Biznese

10,300.00

Planifikimi i të
hyrave nga
bizneset

12,937.25

inkasimi i të
hyrave nga
bizneset





Drejtoria për Ekonomi, dhe zhvillim

Organizimi i konferencës " Forumi Ekonomik Rajonal", në bashkëpunim me Universitetin Haxhi Zeka, ku qëllimi i konferencës ishte përfshirja e universiteteve në planifikimet lokale dhe shfrytëzimin e potencialit për ekspertize në hartimin e projekteve dhe hartimin e strategjive të ndryshme.

Është nënshkruar memorandum bashkëpunimi me organizatën CHWB, për projektin "Zbatimi i brendit rajonal për rajonin ekonomik perëndim, i bazuar në vlerat e përbashkëta të trashëgimisë kulturore", me qëllim krijimin e brendit rajonal për rajonin perëndimor, ku në këtë projekt janë të përfshira edhe Komuna e Pejës, Deçanit, Gjakovës, Istogut dhe Klinës

Në kuadër të programit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë, IPA II, Komuna e Junikut, në bashkëpunim me organizatën CHWB dhe Bashkin e Mirditës(Shqipëri) përgatiten projektin Projekti "Mirdita Juniku", projekt që synon të promovoj turizmin dhe permiresimin e infrastruktures turistike, ky projekt u sigurua nga Bashkimi European, dhe fillon implementimin në muajin Janar 2024 dhe zgjatë 24 muaj.

Korrje – Shirja
e grurit ka filluar me datë: 15.07.2023 – 27.07.2023

MBJELLA 75 HEKTARË ME GRURË
TË KORRURAT~3800 KG/HA



Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mjedis

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis në Komunën e Junikut, në kuadër të saj përfshin Kadastrën, fushën e planifikimit, të ndërtimit, atë mjedisore dhe gjeodezinë.

Spektori për Planifikim dhe Spektori për Urbanizëm:

Përgatitja e Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore,

Lejeve Mjedisore Komunale, Certifikatave të përdorimit, propozimi dhe hartimi i dokumenteve strategjike të planifikimit hapësinor, Përgatitja Certifikatave të legalizimit

5

KUSHTE NDËRTIMORE

Shqyrtimi dhe përgatitja e kërkesave për kushte ndërtimore

3

LEJE NDËRTIMORE

Shqyrtimi dhe përgatitja e kërkesave për Leje ndërtimore

4

EKSTRAKT NGA PZHU, PZHK DHE PRRU

Lëshimi i ekstrakteve nga dokumentet e planifikimit

7

PËRGJIGJE NË KËRKESA TJERA

Përgjigje në kërkesë

4

PËRGJIGJE NË KËRKESA TJERA

Njoftim për plotësim dokumentacioni

0

LËSHIMI I ÇERTIFIKATËS SË LEGALIZIMIT

Përgatitja dhe Shqyrtimi i kërkesave për certifikatë legalizimi



Sektori për Planifikim dhe Sektori për Urbanizëm:

Bën ndryshimet, regjistrimet, modifikimet, ruajtja dhe mirëmbajtja e librave kadastral në përputhje me ligjin për kadastrë si dhe rregullat e caktuara nga Agjensioni Kadastral i Kosovës.

18	Regjistrimi Trashëgimisë
38	Regjistrimi i Kontratave të Shitblerjes
29	Kontratat mbi dhuratën
0	Kontratat mbi shkëputjen e bashkësisë familjare
1	PËRGJIGJE NË KËRKESA TJERA Kontratat mbi këmbimin
1	Bartja e posedimit Aktvendim dhe fitime te posedimit
11	Bashkimi i parcelave
2	Bashkim i personave të njejtë me ID të ndryshme
18	Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit,
18	Modifikimi i atributive të parcelës
1	Fshirja e ngarkesës tjera
0	Modifikimim i drejtës së shfrytëzimit,
4	Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale
3	Modifikim i të drejtave
27	Ndarja e parcelave

1	Regjistrimi i ngarkesës tatimore
3	Regjistrimi i hipotekës
0	Regjistrim i ndërtesës
552	Shërbimi i të dhënave – nxerrja e Certifik
28	Shërbimi i të dhënave – Vërtetim që nuk posedon tokë, dhe
6	Historiat të pronë së paluajtshme
0	Regjistrim e vërejtjes me vendim të gjykatës
1	Modifikim i hipotekës
8	Bartje e posedimit-Ndarja fizike
27	Ndarja e parcelave
11	Bashkimi i parcelave
0	Regjistrimi i objekteve
18	Modifikimi i të dhënave për parcela
326	Krijimi i kopjeve të planit
–	Dhënia e koordinatave



DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT

Raporti për vitin shkollor 2022/2023 në komunën e Junikut tregon statistika nga të gjitha nivelet e Institucioneve të Edukimit të Arsimit. Këto statistika përfshin të dhëna për numrin e fëmijëve, nxënësve, personelit administrativ, teknik dhe mësimdhënësve.

Këto të dhëna tregojnë se si arsimi po zhvillohet në shkollat e komunës tonë dhe se sa individë janë të angazhuar në këtë procesin e arsimit në shkollat e Junikut.

Drejtore në arsimin fiillor dhe i mesëm i ulët

1

Drejtore në arsimin e mesëm i lartë

1

Numri i nxënësve në arsimin fiillor dhe i mesëm i ulët

456

Parashkollorë 3-5 vjeç,
Parafillor 5-6 vjeç


52

Numri i nxënësve në arsimin i mesëm i lartë

166

Pedagog në arsimin fiillor dhe i mesëm i ulët dhe Arsimin e mesëm i lartë

1



Numri i mësimdhënësve në arsimin i mesëm i lartë

37

Punëtor teknik në Arsimin fiillor dhe i mesëm i ulët dhe Arsimin e mesëm i lartë

6

Roje në Arsimin fiillor dhe i mesëm i ulët dhe Arsimin e mesëm i lartë

1

Numri i mësimdhënësve në arsimin fiillor dhe i mesëm i ulët

14

Sekretarë në arsimin fiillor dhe i mesëm i ulët dhe Arsimin e mesëm i lartë

1

Asistent për fëmijë me nevojë të veçante

3

Arsimi fiillor dhe i mesëm i ulët, Nxënës me nevojë të veçante

7



DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT

Testi i Maturës dhe suksesi i arritshmëris së nxënësve

Mbajtja e testit Kombëtar të Maturës është mbajtur sipas planit të MASHTI-it. Testi është mbajtur në objektin e Gjimnazit, dhe i janë nënshtruar 49 nxënës. Në këtë afat kanë pasur rezultat pozitiv 30 nxënës, të tjerët mbetet që të testohen në afatin e dytë.

Testi u mbajt ne hapësirat e shkollës në Gjimnazin "Kuvendi i Junikut" në Junik. Në test morën pjesë 20 nxënës, me rezultat pozitiv ishin 19 nxënës.

Testi imaturës **61.22%**

Testi imaturës afati i dytë **95%**

Rezultati i maturës nga dy testimet **71.01%**

Arsimi Fillorë 1-5
Nota mesatare **4.2**

Arsimi i mesëm i ulët 6-9
Nota mesatare **3.8**

Arsimi i mesëm i lartë 10-12
Nota mesatare **3.56**

Mungesa të arsyeshme në Arsimin Fillorë 1-5 **2811**

Mungesa të arsyeshme e mesëm i ulët 6-9 **7794**

Mungesa të arsyeshme në arsimin e mesëm i lartë 10-12 **6252**

Mungesa të pa arsyeshme në Arsimin Fillorë 1-5 **579**

Mungesa të pa arsyeshme e mesëm i ulët 6-9 **896**

Mungesa të pa arsyeshme në arsimin e mesëm i lartë 10-12 **1753**

- investimi në lyerjen e ambientit të brendshëm të objektit të Gjimnazit "Kuvendi i Junikut". Ky është një investim që do të ndikojë në krijimin e një ambienti të shëndetshëm për nxënësit dhe stafin arsimor
- Është bërë furnizimi me dru dhe pelet për ngrohje për të gjitha objektet shkollore



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Qendra e Mjeksisë Familjare në Junik

Furnizimet Mjekësore

Barnat dhe Reagentët për QKMF:

- Kryer është furnizim me barna për Qendrën Kombëtare Mjekësore Familjare (QKMF), duke përfshirë reagentat për laborator.

Servisimi i Pajisjeve Mjekësore:

- Është nënshkruar një kontratë njëvjeçare për servisimin e pajisjeve mjekësore, duke përfshirë laboratorin e analizave dhe karrigat e stomatologjisë.

Pajisjet mjekësore janë servisuar me sukses, duke siguruar funksionimin e përhershëm të tyre në QKMF.

Blerja dhe furnizimi me aparaturën laboratorike janë kryer në përputhje me specifikacionin dhe nevojat e QKMF.



Aktivitetet tjera Shëndetësore:

- Dy karvane shëndetësore janë organizuar në bashkëpunim me AQH dhe Syri Vision për vetëdijesimin e qytetarëve për parandalimin e sëmundjeve kronike jo-ngjitëse. Aktiviteti ka përfshirë informacion dhe këshilla shëndetësore për hiper tensionin dhe diabetin.
- Marshi Dedikuar Ndërgjegjësimit kundër Kancerit të Gjirit

SHËRBIMET NË QKMF-NË NË JUNIK

**37068**

Shërbime të Përgjithshme

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

**256**

Persona të Vaksinuara me Vaksinen Kundër Gripit Sezonal

VAKSINIMI I FËMIJËVE

**294**

Fëmijë të Vaksinuara sipas grupmoshave të caktuara

PACIENT ME INSULINË

**48**

Pacient kanë jan furnizuar me insulinë

EGZAMINIMET E MAMOGRAFISË

**75**

Pacient kanë bërë Egzaminimet e Mamografisë



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Qendra Për Punë Sociale e Junikut

Furnizimet Mjekësore

Gjatë këtij viti kemi punuar shumë dhe kemi qenë shumë efikas dhe të suksesshëm sepse të gjithë Qytetarëve (Klientëve) që kanë kërkuar ndihmën dhe shërbimet tona ua kemi ofruar në kohë dhe me mirësjellje.

Të gjitha punët dhe aktivitetet e SNS (Skemës së Ndhmës Sociale) janë të paraqitura më poshtë të cilat i kemi kryer duke u bazuar në Ligjin për Skemën e Ndhmës Sociale 2003 /15 dhe në Ligjin për ndryshimin e ligjit të SNS 2003/15, Ligjin 04/L- 096.

•Menaxhimin e Skemës së ndihmës sociale..

•Pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave të reja për ndihmë sociale.

•Verifikimin në terren të kërkesave të reja për ndihmë sociale.

•Pranimi i ri aplikimeve për ndihmë sociale dhe shqyrtimin e tyre.

•Verifikimi dhe riverifikimi në teren i kërkesave të reja dhe ri aplikimeve për ndihmë sociale.

•Pranimi i Raporteve mjekësore, procedimi i tyre dhe dërgimi i tyre në Komision mjekësor për ekzaminim.

•Pranimi dhe shqyrtimi i Ankesave dhe dërgimi i tyre në shkallë më të larta të ankesës.

Operimi me Bazën e të dhënave të SNS-s.

NDIHMA SOCIALE

**45.25**

Familjet përfituese të ndihmës sociale (mesatarja/vjetore)

NUMRI I ANËTARËVE NË ASISTENCË

**152**

Persona të përfshirë në ndihma sociale

FAMILJËT QË KANË RI-APLIKU NË ASISTENCË

**48**

Familjet të cilat kanë ri-aplikuar në Ndhmën Sociale

RI-APLIKIME TË APROVUARA

**48**

Numri i Ri-Aplikimeve të aprovuara në Ndhmën Sociale

FAMILJE TË REJA NË ASISTENCË

**3**

Kërkesa të reja të paraqitura

FAMILJET E LARGUARA NGA NDIHMA SOCIALE

**10**

Familje të larguara nga ndihma Sociale

KËRKESA PËR RIAKTIVIZIM NË NDIHMË SOCIALE

**3**

Kërkesa të pranuar dhe të aprovuara

APLIKACIONE ME RAPORTE MJEKËSORE, PËR PERSONA ME PAAFTËSI FIZIKE,

**38**

Aplikacione me raporte mjekësore, për persona me paaftësi fizike, të aprovuara

FAMILJEGË NUK KANË RI-APLIKUAR

**5**

Numri i Familjeve që nuk kanë ri-aplikuar

SHOQATA HUMANITARE "BEREQETI"

**50**

Pako Ushqimore , ndihma për familjet me nevojë



Drejtoria për Shërbime Publike Inspeksion Mbrojtje dhe Shpëtim

Sektori për Shërbime Publike

Organizon dhe mbikëqyrë rregullimin e qytetit, mbrojtjen e ambientit, mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale të asfaltuara dhe të rendit të katërt, rregullimin e qarkullimit të komunikacionit, sinjalizimin horizontal dhe vertikal, parkingjet, transportin lokal, përcjellë procedurën e pastrimit të ujërave atmosferike nga sipërfaqet publike, mbikëqyrë punën e lëmisë së furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të zeza, menaxhon procedurat e bartjes dhe deponimit të mbeturinave, përcakton lokacionin e kontejnerëve në hapësira publike, pastrimin dhe larjen e rrugëve, shesheve dhe sipërfaqeve publike, mirëmbajtjen e shtratit të lumit Erenik, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e varrezave, mbikëqyrë dhe menaxhon punën e autoparkut të Kuvendit Komunal, cakton lokacionet për parkimin e veturave auto-taksi, vendos për mbylljen e përkohshme të rrugëve, për shfrytëzimin e tyre në raste të veçanta (festa shtetërore, punë të veçanta në interes të shtetit dhe komunës dhe punë të ngjashme) etj.

Sektori për Inspeksion

Mbikëqyrë dhe inspekton të gjitha dukuritë negative që hasen në territorin e komunës së Junikut, inspekton veprimtaritë industriale që mund të shkaktojnë ndotjen e ajrit, dheut dhe ujit që shkaktohen, inspekton procesin e ndërtimit në të gjitha fazat dhe verifikon përputhshmërinë me dokumentacionin ndërtimor, sigurohet që janë ndërmarrë masat adekuate të sigurisë së objekteve në ndërtim, objekteve të tjera përreth dhe komunikacionit, në përputhje me ligjin merr masa mbrojtëse për shëndetin e popullatës nga veprimi i dëmshëm i produkteve të duhanit, dhe i pirjes së duhanit, mbikëqyrë ekspozimin e mallrave jashtë lokaleve afariste, ndalimin e shfrytëzimit (vendosjes) pa leje të hapësirave publike, vënien e mbishkrimeve, reklamave, vitrinave, objekteve publike dhe higjienike, hoteliere, sallave publike, mbikëqyrë zbatimin e dispozitave për vënien e panove dhe të reklamave të të gjitha llojeve, mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore nga lëmi i komunikacionit dhe të mjeteve motorike në qarkullimin publik,

62

Inspektime të
përgjithshme me
procesverbal

24

Inspektime në
biznese të
ndryshme

06

Procesverbale në
lëmin e ndërtimit

05

Aktvendimeve për
veprimnatrin e
bizneseve të reja

3

Ndërprerje e
punimeve

23

Pëlqime



Drejtoria për Shërbime Publike Inspeksion Mbrojtje dhe Shpëtim

Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim

Vlerëson rrezikshmërinë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera brenda territorit të komunës, si dhe harton planet për mbrojtje, kujdeset për funksionimin dhe aktivizimin e Sistemit të Alarmit Publik në rast të rrezikut, është përgjegjës për organizimin e qytetarëve në forcat për mbrojtje dhe shpëtim, në rast nevojë si dhe propozimin për themelimin e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim, në përputhje me ligjet dhe në rast nevojë është përgjegjëse për koordinimin e punëve me institucionet qendrore dhe komunat tjera në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit, në rastet e jashtëzakonshme i propozon Kryetarit të Komunës shpalljen e gjendjes Emergjente, si dhe masave që duhet të ndërmerren për përballimin e situatës, kujdeset për mirëmbajtjen dhe funksionalizimin e strehimoreve publike, në përputhje me ligjet dhe aktet komunale, harton Planin për Mbrojtje nga Zjarri, Planin Operativ Emergjent dhe Planin nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, ndërmerr masa për parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

76

Numri total i
Intervenimeve

43

Intervenime në
luftimin e zjarrit

10

Intervenime
teknike

17

Intervenime në
shërbime

2

Intervenime në
aksidente

3

Intervenime në
vërshime

Riasfaltimi i rrugës Gaxherr – Shalaj – Bajraktar

Investitor

Komuna Junik

Ky projekt ka një rëndësi të veçantë për zhvillimin e rajonit dhe tërheqjen e investimeve të reja në zonën rurale. Riasfaltimi i kësaj rruge do të ndikojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe në rritjen e vlerës së pronave për qytetarët e kësaj zone. Përkushtimi nga ana e Kryetarit të Komunës z. Ruzhdi Shehu për realizimin e projektit tregon se kjo rruge është e rëndësishme për qytetarët dhe zhvillimin e rajonit.



Asfaltimi i segmentit Gjocaj-Livadhi i madh në rrugën Junik-Gjeravicë

Investitor

Komuna Junik

Ministria e infrastrukturës

Kjo rrugë do të ketë ndikim të thellë në zhvillimin ekonomik dhe në krijimin e mundësive të reja për qytetarët e Junikut dhe për turistët që do të vizitojnë këtë zonë. Rruga e re do të sjellë përparësi të reja në sektorin e turizmit, duke e bërë qasjen për turistët më të lehtë dhe duke krijuar mundësi të reja për investime në industrinë e turizmit. Kjo nxitje në infrastrukturën rrugore do të ndihmojë në rritjen e numrit të vizitorëve dhe në zhvillimin e ekonomisë lokale.



Hapja e rrugës fushore Troja në lagjen Qestaj

Investitor

Komuna Junik

Hapja e rrugës fushore krijon një infrastrukturë të përshtatshme për transportin e kërkesave bujqësore, duke përfshirë furnizimet e plehrave, ujin dhe inputet e tjera të nevojshme për bujqësinë. Kjo mund të ndihmojë në rritjen e produktivitetit bujqësor dhe të kontribuojë në një rritje të përgjithshme të sektorit bujqësor në zonën e lagjes Qestaj



Ndërtimi i urë mbi lumin Erenik që lidh dy eko fshatrat Gjocaj dhe Jasiq

Investitor

Komuna Junik

Ministria e Zhvillimit Rajonal

Komuna e Junikut dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal kanë bërë një hap të rëndësishëm me ndërtimin e urës mbi lumin Erenik, që do të lidhë fshatrat Gjocaj dhe Jasiq. Ky projekt është rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë dhe të suksesshëm ndërmjet autoriteteve lokale dhe qendrore. Përmirësimi i lidhjeve rrugore do të sjellë një avancim të shërbimeve komunale, si dhe do të hapë rrugën për mundësi të reja për zhvillim ekonomik dhe social. Ky investim në infrastrukturë thelbësore shërben si shembull i përpjekjeve të përbashkëta për rritjen e cilësisë së jetesës dhe fuqizimin e komunitetit në këtë zonë.



Kanalizimit në lagjet Miroc, Gaxherr, Çok dhe Bajraktar

Investitor

Komuna Junik

Punimet e kanalizimit kanë zgjidhur problemet e ujërave të zeza dhe ndotjes së mjedisit, duke krijuar një ambient më të pastër dhe të shëndetshëm për komunitetin e lagjeve Miroc, Gaxherr, Çok dhe Bajraktar.



Ndërtimi i kanaleve të ujitjes 4100 m

Investitor

Komuna Junik

Ministria e Bujqësisë


Një furnizim i qëndrueshëm me ujë është një faktor kritik për rritjen e produktivitetit të bujqësisë dhe rritjen e nivelit të prodhimit bujqësor. Ky projekt do të sigurojë që fermerët e Komunës së Junikut të kenë qasje të mjaftueshme në burimin më të çmuar për kultivimin e tokave të tyre, duke përmirësuar prodhimntarin në fermat e tyre.



Punimet në muret mbrojtëse dhe Kanalet e Ujitjes në Lagjet Tofaj dhe Pepsh

Investitor
Komuna Junik

Muret mbrojtëse janë ndërtuar për të shërbyer në uljen e rrezikut të rreshqitjes së dheut, duke krijuar një mjedis më të sigurt për banorët e këtyre lagjeve. Ndërkohë, punimet në kanalet e ujitjes do të ndihmojnë në krijimin e kushteve të përshtatshme për bujqit, duke siguruar akses më të mirë ndaj burimeve të ujit duke ndihmuar në zhvillimin e bujqësisë.



Punimet në përmirësimin e infrastrukturës në amfiteatrin e hapur në " Moronicë" dhe në parkun përgjatë lumit Erenik

Investitor

Komuna Junik dhe CHWB



Ky projekt është relaizuar në bashkëpunim me komunën dhe ChwB në kuadër të programit "Zhvillimi i Rajonit Ekonomik Perëndim përmes Trashëgimisë Kulturore", projekt i iniciuar nga CHwB Kosova dhe i realizuar në bashkëpunim me gjashtë komunat e rajonit ekonomik perëndim.





Vendosja e rrethojave mbrojtëse për sigurinë e fëmijëve dhe qytetarëve të Junikut

Investitor
Komuna Junik



Kryetari i Komunës së Junikut, z. Ruzhdi Shehu, është i përkushtuar që krahas projekteve madhore, të fokusohet edhe në projektet që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e qytetarëve, e në veçanti të fëmijëve.

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspeksion ka realizuar projektin e vendosjes së rrethojave mbrojtëse në disa lokacione kryesore në qytet, me qëllim të rritjes së sigurisë për qytetarët dhe në veçanti për fëmijët.

Ky projekt është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të z. Shehu për të përmirësuar sigurinë në komunë. Rrethojat janë vendosur në dy lokacione kryesore: Shkolla Fillore "Edmond Hoxha" dhe ura në lagjen Berish.

Vendosja e Shportave për Mbeturina

Investitor
Komuna Junik
M4Y



Vendosja e Shportave për Mbeturina ne komunën e Junikut është një proces i rëndësishëm që ndihmon në menaxhimin e mbeturinave në mënyrë efikase. Shportat janë vendosur në vende kyçe të komunës, duke lejuar qytetarët të hedhin mbeturinat e tyre në një mënyrë të organizuar dhe të përgjegjshme. Kjo masë jo vetëm që ndihmon në mbajtjen e qytetit të pastër, por gjithashtu promovon një mjedis më të shëndetshëm dhe të sigurt për të gjithë banorët. Kjo iniciativë tregon se si një veprim i thjeshtë si vendosja e shportave mund të ketë një ndikim të madh në mjedisin tonë.

Sinjalizimi i rrugëve në komunën e Junikut

Investitor

Komuna Junik

Sinjalizimi i rrugëve në komunën e Junikut është një aspekt kyç i sigurisë. Kjo përfshin vendosjen e vijave të bardha rrugore, treguesve të drejtimit, sinjaleve të kufizimit të shpejtësisë, dhe shenjave të tjera që ndihmojnë në udhëzimin e trafikut dhe parandalimin e aksidenteve. Këto sinjale janë të vendosura në mënyrë strategjike nëpër rrugët kryesore dhe sekondare të komunës për të siguruar që të gjithë udhëtarët, përfshirë shoferët, biciklistët dhe këmbësorët, mund të udhëtojnë në mënyrë të sigurt dhe efikase.



Objekti i ri i SHFMU “Edmond Hoxha”

Investitor
MASHT
Komuna Junik

Objekti i ri i SHFMU “Edmond Hoxha”. Në bashkpunim me MASHTI, kemi funksionalizuar objektin e ri të shkollës, duke pajisur me mjete të punës, Internet dhe kamera të sigurisë, si rezultat i kësaj sot kemi një ambient më praktik dhe bashkohor, që do të ndikoj në rritjen e cilësisë së arsimit. Gjithashtu kemi me dollapë për fëmijët e klasës së para deri në klasën e pestë, që nxënësve t’u mundësohet që mjeteve të punës ti vendosin në dollapë dhe mos ti bartin në çanta, kjo do të ndikon në ruajtjen e shëndetit dhe mërqinjën e fëmijëve.



Gjimnazit “Kuvendi i Junikut” me Panele solar me sistem akumulues

Investitor
Komuna Junik
CARITAS

Në objektin e Gjimnazit “Kuvendi i Junikut” kemi vendosur panele solar me sistem akumulues të energjisë elektrike me kapacitet 4KË/h, projekt u mbështet nga Caritasi Zviceran, komuna e Junikut, kurse projekti u zhvilluar nga nxënësit e shkollës dhe mësime dhënësit. Projekti do të ndikoj ruajtjeje ambientin dhe kursimin e energjisë elektrike





Ndërtimi i parkut “Sheshi i Dëshmorit të Kombit Gëzim Pepshi”

Investitor

Komuniteti i lagjes Pepshi

Komuna Junik





Ndërtimi i parkut të lodrave për fëmijë pranë lumit Erenik

Investitor
Komuna Junik
KFOR-i Italian



Pastrimi i Deponive Ilegale në Komunën e Junikut për të Ruajtur Ambientin Natyror

Investitor

Komuna Junik

Komuna e Junikut, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspeksion, ka bërë pastrimin e të gjitha deponive ilegale të krijuara në territorin e Junikut. Me përkushtim dhe angazhim të madh, të gjitha deponitë janë pastruar, duke sjellë ndryshime të dukshme në peizazhin tonë natyror.

Kjo përpjekje e madhe për pastrim është realizuar me qëllim që të ruajmë bukurinë natyrore të Junikut dhe të sigurojmë një mjedis të pastër për banorët dhe vizitorët tanë. Deponitë ilegale janë shkaktarë të ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit, duke krijuar rreziqe serioze për shëndetin dhe ekologjinë tonë.



QKMF në Junik funksionalizohet 24/7, gjithashtu është funksionalizuar edhe aparatura e rentgenit

Investitor



Komuna Junik

Për më shumë se një dekadë QKMF në Junik ka funksionuar vetëm disa orë gjatë ditëve të punës duke detyruar banorët e Junikut që të shkojnë në komuna përreth që të marrim shërbime mjekësore.

Nga tani dhe tutje Qendra e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Junik do të funksionoj 24 orë në ditë gjatë 7 ditëve të javës. Njëkohësisht është funksionalizuar edhe aparatura e rentgenit duke mundësuar edhe ofrimin e të gjitha shërbimeve radiologjike nga QKMF Junik. Pra të gjitha shërbimet mjekësore që ofrojnë QKMF në çdo komunë tjetër, prej tani do të ofrohen edhe në QKMF në Junik.

Funksionalizimi i QKMF pas kaq shumë viteve ka qenë një nga premtimet tona kryesore elektorale. Me kënaqësi sot ju konfirmojmë që edhe ky premtim është përmbushur me sukses.

Me këtë rast duhet të falenderojmë edhe kompaninë KosovaMed Healthcare për donacionin e pajisjeve të brendit botëror japonez Fujifilm të cilat mundësojnë funksionalizimin e rentgenit analog së bashku me digjitalizerin Fujifilm Prima TM si dhe printerin e filmave radiologjik Fujifilm Drypix EDGE së bashku me pajisjet përcjellëse.



Të gjithë me plisa - Plisi Shqiptar në Unesco

Investitor

Komuna Junik

Aktiviteti përfshiu lexime emocionuese të poezive, ekspozita artistike dhe një homazh para Lapidarit të Heroit të Kombit Edmond Hoxha, si dhe përpara varrezeve të dëshmorëve në Koshare. Me ndjenjën e bashkëpunimit dhe krenarisë për trashëgiminë kombëtare, ky ngjarje solli një ditë të shkëlqyer për promovimin e kulturës shqiptare në skenën ndërkombëtare, falë përkushtimit të të gjithë pjesëmarrësve.



Turneu i pingpong- ut të seniorëve “Dita e Pavarësisë” në Junik

Investitor

Komuna Junik

Federatën e PingPongut të Kosovës

Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Klubi Pingpongut “Juniku”.

Në palestrën e sportit “Ereniku” në Junik është mbajtur turneu në pingpon për nder të 15 vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Në këtë turne kanë marr pjesë ekipet dhe lojtarët më të mirë të PingPong - ut nga e tërë Kosova dhe Shqipëria.



Manifestimi tradicional "Dita e Gështenjës"

Investitor

Komuna Junik

CNVP



Komuna e Junikut ka organizuar manifestimin tashmë tradicional "Ditët e Gështenjës". Ky organizim i cili është përkrahur nga CNVP, që ka për qëllim promovimin e produkteve vendore me anë të një panairi i cili gjithashtu është pjesë e organizimit "Ditët e Gështenjës".

Këtë manifestim e bëri të veçantë pjesëmarrja e mysafirëve nga shteti gjerman, gjegjësisht nga Komuna Nuthe-Urstromtal. Kryetari i komunës, z. Stefan Scheddin, me bashkëpunëtor, ku nesër Komuna e Junikut dhe Komuna Nuthe-Urstromtal pritet të nënshkruajnë marrëveshjen e binjakëzimit. Gjithashtu, këtë manifestim e bënë të veçantë mysafirët nga diaspora jonë të cilët janë edhe afaristë të njohur në shtetin gjerman atje ku veprojnë dhe punojnë, z. Mustafë Abazi, z. Burim Mehmetaj, z. Fatos Xhafolli.



Koncerti i organizuar nga Komuna e Junikut për nder të mërgimtarëve junikas

Investitor

Komuna Junik



Mirëmbajtja e ndriçimit publik

Investitor

Komuna Junik

Ndriçimi publik është një shërbim i domosdoshëm për qytetarët e Junikut, i cili siguron siguri dhe vizibilitet gjatë orëve të errëta. Kjo arritet nëpërmjet ndriçimit të të gjitha rrugëve lokale dhe hapësirave publike. Kjo përfshin rrugët e lagjeve, parket, sheshet dhe zonat e tjera të përdorura nga komuniteti. Kështu, ndriçimi publik jo vetëm që rrit sigurinë duke parandaluar aksidentet dhe krimin, por gjithashtu mundëson aktivitete sociale dhe ekonomike pas orëve të punës, duke përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë banorët e Junikut.



Mirëmbajtja e hapësirave publike

Investitor

Komuna Junik

Mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe hapësirave publike në Junik është një shërbim i domosdoshëm që kontribuon në krijimin e një ambienti të pastër për qytetarët. Kjo përfshin pastrimin e rrugëve, mbjelljen e luleve dhe pemëve, dhe mirëmbajtjen e zonave të lojërave për fëmijë. Këto veprime jo vetëm që ndihmojnë në ruajtjen e bukurisë së qytetit, por gjithashtu promovojnë një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt për të gjithë banorët.



Mirëmbajtja e kanalizimit të ujrave të zeza

Investitor

Komuna Junik

Mirëmbajtja e sistemit të kanalizimit të ujrave të zeza në komunën e Junikut është një detyrë e rëndësishme që siguron shëndetin dhe mirëqenien e banorëve të saj. Kjo përfshin monitorimin e vazhdueshëm dhe riparimin e rrjetit të kanalizimit për të parandaluar bllokimet dhe për të siguruar që ujrato të zeza të drejtohen drejt impianteve të trajtimit të ujrave.



Mirëmbajtja e urave mbi shtratin e lumit Erenik

Investitor

Komuna Junik

Mirëmbajtja e urave mbi shtratin e lumit Erenik në Junik ka përfshirë një sërë veprimesh të rëndësishme, duke përfshirë riparimin dhe ngjyrosjen e tyre. Këto veprime janë të domosdoshme për të siguruar që urat të jenë të sigura dhe të qëndrueshme për përdorim nga qytetarët. Riparimi i urave mund të përfshijë ndërhyrje të ndryshme, si p.sh. forcimi i strukturave, zëvendësimi i pjesëve të dëmtuara, ose riparimi i dëmtimeve të shkaktuara nga erozioni apo ndryshimet e temperaturës. Ngjyrosja e urave, përveç se i jep atyre një pamje të pastër dhe të mirëmbajtur, gjithashtu ofron një shtresë mbrojtëse kundër ndikimeve të mjedisit, si p.sh. lagështia dhe korrozioni. Kështu, mirëmbajtja e urave mbi lumit Erenik në Junik kontribuon në sigurinë dhe lëvizshmërinë e qytetarëve



Mirëmbajtja e dimërore e rrugëve lokale

Investitor

Komuna Junik

Mirëmbajtja e dimërore e rrugëve lokale në Junik është një detyrë e rëndësishme që siguron që rrugët të jenë të sigurta dhe të kalueshme gjatë muajve të ftohtë. Kjo përfshin veprime si pastrimi i borës, shpërndarja e kripës për të parandaluar akumulimin e akullit. Këto veprime jo vetëm që rrisin sigurinë e udhëtarëve, por gjithashtu minimizojnë ndërprerjet e trafikut dhe ndihmojnë në ruajtjen e infrastrukturës rrugore. Prandaj, mirëmbajtja e dimërore e rrugëve lokale në Junik është thelbësore për funksionimin e përditshëm të qytetit gjatë stinës së dimrit.



Dekorimi i qytetit të Junikut për festat e fundvitit

Investitor

Komuna Junik





Nënshkrimi i marrëveshjes binjakëzimit me komunën Nuthe Urstromtal- Gjermani

Investitor

Komuna Junik





Punimet në Zyrën Informuese të Turizmit, materialet promovuse, web faqja

Investitor

Komuna Junik





<https://kk.rks-gov.net/junik>
Telefoni pa Pagesë
0800 11020

2023



Komun Junik